

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, nga gjyqtari Refki Piraj, me procesmbajtësen Halime Nixha, sekretare juridike e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër te akuzuarve Si ... G ... nga Prizreni dhe G ... B ... nga fsh. ... , Komuna e Suharekës, te akuzuar sipas aktakuzës se PTH ne Prizren PP.nr.189/14 e dt.18.03.2014 dhe PP.nr.189/14 e dt. 07.04.2014, për shkak të veprave penale te vjedhjes se rende nga neni327/1-1- 28- 31 te KP. në prezencën e të akuzuarve, prokurori i shtetit Besim Susuri , më dt.23.06.2016 mur dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

Te akuzuarit

1. S ... G ... , i lind. me ... ne fsh. ... Komuna e Suharekës me banim ne Prizren, lagja bazhdaranë rr. ... , nga i ati A ... , e ema F ... , e lind. E ... , ka te kryer 7 klase te shkollës fillore, i martuar, , punëtor, i gjendjes se dobët ekonomike shqiptar, shtetas i R. të Kosovës.

2. G ... B ... , i lindur me ... ne Suharek me banim ne fsh. ... , nga i ati Z ... dhe e ema Sh ... , e lind. Xh ... , ka te kryer shkollën fillore , i martuar, babe i l femiu, punëtor, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar shtetas i R. te Kosovës.

JANË FAJTOR

I. Se me dt.11.12.2013 rreth orës 18:30 ne Prizren, ne rrugën "Joni" saktësisht ne Parkingun e QT "Abi" i pandehuri ne bashkëveprim me te dyshuarin G ... B ... , duke depërtuar me force ne veturat e mbyllura me qellim te përvetësimit te pasurisë se luajtshme, tentojnë t'ia marrin veturën e markës "Golf 3" me shenjen regjistruese 04-412-AB, ngjyre hiri, prone e te dëmtuarit B ... Q ... , ne momentin kur i dëmtuari veturën e tij te markës "Golf 3" e parkon ne parkingun e qendrës tregtare "Abi" ne momentin kur tenton t'ia ndezë veturën e tij vëren se çelësi i veturës ishte i thyer ne bravën e automjetit deri sa te pandehurit kane tentuar qe me force ta bëjnë në lëvizje automjetin gjegjes.

Këso dore ne bashkëkryerje kane kryer veprën penale vjedhje e rende ne tentative nga neni 327/1-1- 28- 31 te KP.

II.Se me datë te njëjte te përshkruar si ne dispozitivin I te aktakuzës rreth ore 17:50 min , ne Prizren , ne rrugën "Komuna e Parisit" ne afërsi te parkingut te QT "Abi" ne bashkëveprim me te dyshuarin G ... E ... duke depërtuar me force ne veturat e mbyllura ose duke hequr pengesat me qellim te përvetësimit te pasurisë se luajtshme, e marrin veturën e markës 2VW Golf3" me shenjen regjistruese ... , me ngjyre te bardhe prone e te dëmtuarit F...

Th. 35, dhe te njëjtën veturë pasi që e vjedhin ia shesin dhe bëjnë nderim me automjetin e markës “Audi 80” prone e te dëmtuarit Q. ... Komuna e Malishevës, ashtu që vetura e markës “Golf 3” me shenjen regjistruese ... i kthehet te dëmtuarit R. ... me vërtetim mbi kthimin e gjësendeve.

Keso dore ne bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e rende nga neni 327/1-1-31 te KP.

III. se me datën 19.01.2014 rreth orës 16:00 min ne Prizren ne rrugën “Enver Haradinaj” saktësisht te parkingu i fushës sportive “Andra” ne bashkëveprim me te dyshuarin G. ... duke depërtuar me force ne veturat e mbyllura ose duke hequr pengesat me qellim te përvetësimit te pasurisë se luajtshme e marrin veturën e markës “Golf 2” me shenjen regjistruese ... prone e te dëmtuarit F. ... ne ate menyre ne momentin ku i dëmtuari e parkon veturën e tij te markës 2Golf 2” ne parkingun te fusha sportive “Andra” te pandehurit ne shfrytëzojnë momentin e volitshëm mos prezencën e te dëmtuarit e marrin veturën e markës “Golf 2” me ngjyrë te kuqe me targa te regjistrimit ... dhe mjetet e punës si nje hilt, nje share elektrike nje çekan i hekurt te cilat mjete kane qene ne automjetin gjegjës, te pandehurit automjetin me pas e shesin ne Gjakove ne vlerën prej 200 euro, pasi që automjeti gjegjës gjendet nga ana e policisë i kthehet te dëmtuarit F. ... me vërtetim mbi kthimin e gjësendeve.

Këso dore ne bashkëkryerje kane kryer veprën penale vjedhje e rende ne tentative nga neni 327/1-1-28 -31 te KP.

Te akuzuarit veprat penale kane kryer ne vazhdimësi bazuar ne nenin 81 te KP.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 41,43, 49, 50, 51 , 52 dhe 81 te KP t e akuzuarve iu shqipton :

DËNIM ME BURG

Te akuzuarit S. ... G. ... me burg ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh . Koha e kaluar ne paraburgim prej dt.25.01.2014 deri me dt. 24.03.2014 do ti llogaritet ne dënimin e shqiptuar me burg .

Të akuzuarit G. ... B. ... me burg ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh.

Dhe

DËNIM ME GJOBË

Te akuzuarit S. ... G. ... dënimin me gjobe në shume prej 400 (katërqind) euro. te cilin dënim duhet ta paguaj ne xhirologarinë e kesaj gjykate nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, e poqese dënimi me te holla nuk mund te paguhet nga ana e te akuzuarit ne afatin e sipërpërmendur I njëjti do te zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur 20 euro per 1 ditë burg qe do te thotë 20 (njëzet) dite burg.

Te akuzuarit G. B. dënimin me gjobe në shume prej 400 (katërqind) euro, te cilin dënim duhet ta paguaj ne xhirollogarinë e kësaj gjykate nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, e po qese dënimi me te holla nuk mund te paguhet nga ana e te akuzuarit ne afatin e sipërpërmendur I njëjti do te zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur 20 euro per 1 ditë burg qe don te thotë 20 (njëzet) dite burg.

Të dëmtuarit: B. Q. nga Prizreni, R. Th. nga Prizreni, F. (N.) S. nga Prizreni dhe Q. (O.) G. nga fsh. Komuna e Malisheves, per realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

Obligohen të pandehurit qe ti paguajnë te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato bëhen ne baze te llogarisë se gjykatës, , kurse ne emër te paushallit gjyqësor secili veq e veq te paguajnë shumen prej nga 100 (njëqind) euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcënim te ekzekutimit te dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria themelore ne Prizren me aktakuzën PP.nr.189/14 e dt.18.03.2014 dhe PP.nr.189/14 e dt. 07.04.2014, i kanë akuzuar S. G. dhe G. B., për shkak të veprave penale te vjedhjes se rende nga neni 327 par.1.1-31 te KP.

Me qenë se në këtë procedure fjala është për dy te bashkëpandehur, per te cilët janë ngritur aktakuza te veçanta, atëherë behet bashkimi i kësaj procedure bazuar ne nenin 35 te KPP.

Te akuzuarit S. G. dhe G. B. në shqyrtimin fillestar , në tërsi i kanë pranuar veprat penale të cilat u vihen ne barre sipas aktakuzës , e po ashtu kanë pranuar edhe fajësinë .

Gjyqtari gjykues, pas marrjes se mendimit edhe te prokurorit te shtetit, ka vlerësuar se një pranim i tillë ka mbështetje në provat të cilat i përmban aktakuza , prandaj pranimin e fajsisë e ka aprovuar.

Kjo gjykatë gjeti se në veprimet e të akuzuarve , plotësohen të gjitha elementet qenësore te veprave penale te vjedhjes se rende nga neni neni 327/1-1-28 -31 te KP dhe 327 par.1.1-31 te KP,ne rrethana te kryera ne vazhdimësi sipas nenit 80 te KP, prandaj dhe ua shqiptoi dënimin me burg si dhe dënim me gjobë.

Gjatë matjes dhe caktimit te dënimit gjykata aplikoi nenin 73 dhe 74 te KP-së, per te gjetur dhe çmuar faktin se te akuzuarit kanë pranuar fajësinë qe ne shqyrtimin fillestar dhe se janë përmbushur kushtet ligjore qe ndaj te akuzuarve te aplikohen dispozitat mbi zbutjen e dënimit duke shqiptuar dënimin me burgim nen minimumin ligjorë dhe atë me aplikimin e nenit 75 te KP-së me bindjen se edhe me këto dënime do te arrihet qëllimi i tyre.

Me rastin e shqiptimit të dënimit kjo gjykate pati parasysh si rrëthana lehtësuese për të akuzuarin, pendimin e thellë për veprën e kryer, moshën relativisht të re, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejnë me vepra penale, sjelljen korrektë para gjykatës, si dhe gjendjen e dobët ekonomike.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në kuptim të nenit 450 dhe 452 të KPPK-se.

Vendimi mbi udhëzimin në kontest civil u marrë në kuptim të nenit 463 par.2 të KPK.

Më sa u tha më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.399/14 të dt.23.06.2016

Procesmbjatesja:
Halime Nixha

Gjyqtari:
Refik Piraj



DHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kesaj gjykate.